

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"G&G LAW FIRM"

NENI 1

Themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "G&G LAW FIRM", mbeshtetur ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjin nr. 9121, date 28.7.2003, "Per Mbrojtjen e Konkurrences", Kodin Civil dhe Kodin e Punes me ortakun themelues si vijon:

Gjin Gjoni, i biri i Gjon dhe Dave, i datëlindjes 09.03.1970 lindur ne Lezhe dhe banues ne Tiranë në adresen, Rolling Hills Vila nr 69, Farke, Tirane, person madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr. 030859115 dhe nr. personal H00309108Q;

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

1. Selia e Shoqerise ndodhet në Qytetin e Tiranës në adresën Rruga Papa Gjon Pali II Pallati nr. 1, shkalla 1, Ap. 37, Njesia Bashkiake nr 2.
2. Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe jashte vendit, ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Tiranës.
3. Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se pergjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet, mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjetër.

KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqerisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.



OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Avokatia;
- Ofrimi i shërbimeve ligjore personave fizike dhe juridike, shqiptare apo të huaj,
- Dhënia e këshillave dhe e shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distance;
- Shërbimet ligjore mbrojtëse;
- Përgatitja e dokumentave ligjore;
- Perfaqësimi në gjykate dhe përpara organeve të tjera shtetërore e institucioneve të tjera;
- Sigurimi i informacionit juridik;
- Plotësimi i akteve të ndryshme juridike;
- Dhënia e këshillave juridike për personat që kryejnë vetë përfaqësimin në gjykatë;
- Këshillimi financiar;
- Shërbimi i rekrutimit për të gjitha fushat e aktiviteteve profesionale që ushtrohen në Republikën e Shqipërisë;
- Trajnimi i stafëve të shoqërive tregtare;
- Ndërmjetësimi; dhe
- Këshillime në çdo fushë tjetër.

KAPITALI I SHOQERISE


NENI 5

1. Kapitali i shoqërisë përbehet nga 1 (nje) kuote në vlerën 100.000 lekë.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal që lejon ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KONTRIBUTET

NENI 6


Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortaku i shoqërisë **Gjin Gjoni**.




ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 7

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë (përfshihet përfaqësimi i një ortaku nga një ortak tjetër apo administratori i shoqërisë).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po që se ka të tilla, nga likuiduesit apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë, ose nepermjet postës elektronike të deklaruar paraprakisht nga palët.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
 - d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
 - e) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertëve kontabel të autorizuar;



- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Lidhjen e të gjitha kontratave me palë të treta ku shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat;
- n) Blerjet dhe të gjitha shpenzimet e tjera që kryen shoqëria;
- o) Strukturën dhe nivelin e pagave të të punësuarve në shoqëri;
- p) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja përgjithshme vendos me shumice të zakonshme për cështje të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 15 më poshtë të këtij neni. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave dhe vendimet merren me 2/3 e ortakeve pjesemarres.
15. Asambleja e përgjithshme vendos me shumice të kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe çdo cështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme bëhet vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave janë të pranishëm, votojnë me shkrese apo mjete elektronike. Në këto rast vendimet merren me 3/4 e votave të ortakeve pjesemarres.
16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këto pikë, të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



4

ADMINISTRIMI


NENI 8

1. Shoqëria administrohet nga nje ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se pergjithshme sipas parashikimit ne kete statut.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

NENI 9

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Për të gjitha transaksionet në formën e detyrimeve për shoqërinë, duke përfshirë, por pa u kufizuar te të gjitha shpenzimet për shkak të blerjeve, marrëdhënieve të punës, investimeve, huave apo formave të tjera me apo pa kontratë të shkruar, administratori do të veprojë me miratim paraprak të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.
3. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme per sa parashikon ky statut ose ligji.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.



5

EMERIMI I PARE I ADMINISTRATOREVE

NENI 10

Administrator i pare i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare, duke filluar nga themelimi i shoqërisë, emërohet Erjon Hastoçi.

EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR

NENI 11

1. Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumice të zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

E DREJTA E VOTES

NENI 12

Cdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotes së tij.

E DREJTA PËR TË KALUAR REZOLUTE

NENI 13

Asambleja e përgjithshme mund të miratojë rezolute pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratohet një rezolute në mbledhjen e asamblese së përgjithshme duhet të jenë të pranishëm të gjithë ortakët personalisht dhe ta votojnë atë në mënyrë të unifikuar.


ZHVILLIMI I SHOQERISE

NENI 14

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, seline ligjore, objektin, mund të zmadhojë apo të zvogelojë kapitalin themeltar, mund të pranojë ose të largojë ortakë.

MARREDHENIET E PUNES NE SHOQERI

NENI 15



Shoqeria do te perpiloje dokumentet perkatese per punesimin e personave te trete duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

VULA E SHOQERISE

NENI 16

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme me tekstin perreth saj.

FITIMI I PERSONALITETIT JURIDIK

NENI 17

Shoqeria do te rregulloje veprimtarine e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi te nenshkruhet nga ortakët themelues do te fitoje personalitet juridik ne ditën e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

BILANCI DHE FITIMI

NENI 18

18. 1. Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.

18.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.

18.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

FUNKSIONIMI I SHOQERISE

NENI 19

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoqerise pervec ketij Akti Themelimi jane te percaktuara ne Statutin e Shoqerise.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

NENI 20

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore, personat juridike e fizike vendas e te huaj, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas legjislacionit ne fuqi.

DISPOZITA TE TJERA



7

NENI 21

Ky akt themelimi perpilohet ne tre kopje, duke patur secila kopje fuqi te plate ligjore.

Autorizohet Administratori Erjon Hastoçi për regjistrimin e shoqërisë pranë QKR-së.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues të Shoqërisë "G&G LAW FIRM".

THEMELUESI I SHOQËRISË
GJIN GJONI

Tirane, më 19.10.2020



Ishqiptaria.com